



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETIVE

Nr. 1877 Prot

Himarë, më 11.03.2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim dhe miratim relacioni dhe projektvendimi për tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029, Faza 1.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË ✓
Sekretarit të këshillit **Z. Zaho Dedi**

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor”i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, ”, po ju dërgojmë relacionin dhe projektvendimin për tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029, të Bashkisë Himarë.

Faleminderit për bashkëpunimin.

KRYETAR

Yangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 1877/Prot
1

Himarë, më 11.03.2026

PROJEKT VENDIM

NR. 13 DT. 11.03,/2026

“PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN 2027–2029, Faza 1.”

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor” i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, po ju dërgojmë relacionin dhe projektvendimin për tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029 të Bashkisë Himarë.

VENDOSI:

1. Të miratohen tavanet përgatitore të programeve buxhetore 2027-2029 të Bashkisë Himarë.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Bashkia Himarë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETIVE

Nr. 1877/Prot
2

Himarë, më 11.03.2026

Lënda: Relacion shpjegues mbi miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029, Faza 1.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

KËTU

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor”i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, po ju dërgojmë tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029 të Bashkisë Himarë.

Në zbatim të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe të funksioneve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, si dhe në kuadër të procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) për periudhën 2027–2029, paraqiten për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli Bashkiak tavanet e shpenzimeve sipas programeve buxhetore.

Tavanet e propozuara përbëjnë instrumentin kryesor financiar për planifikimin e shpenzimeve dhe orientimin e politikave zhvillimore të bashkisë në periudhën afatmesme. Hartimi i tyre është mbështetur në parimet e qëndrueshmërisë fiskale, menaxhimit të kujdesshëm të burimeve financiare dhe rritjes së investimeve publike me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Totali i taveaneve të përgjithshme për periudhën 2027–2029 parashikohet në nivelin 8,245,810 për vitin 2027, 9,421,320 për vitin 2028 dhe 9,805,990 për vitin 2029. Struktura e buxhetit paraqet një trend rritës ndër vite, i orientuar kryesisht drejt investimeve kapitale dhe zhvillimit të infrastrukturës publike.

Programi “Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi” garanton funksionimin normal të institucionit dhe mbështet kapacitetet administrative të bashkisë. Për këtë program janë parashikuar fonde në vlerën 570,000 për vitin 2027, 614,500 për vitin 2028 dhe 615,000 për vitin

2029. Fondet mbulojnë shpenzimet e personelit, shpenzimet administrative dhe investimet për përmirësimin e infrastrukturës administrative dhe digjitalizimin e proceseve të punës.

Programi “Shërbimet e Policisë Vendore” parashikon fonde në vlerën 17,000 për vitin 2027, 17,100 për vitin 2028 dhe 17,200 për vitin 2029. Ky program mbështet ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në territor, përmes financimit të shpenzimeve operative dhe investimeve në pajisje dhe mjete logjistike për rritjen e kapaciteteve operacionale.

Programi “Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile” është një nga programet me rëndësi strategjike për menaxhimin e emergjencave civile. Fondet e parashikuara janë 257,000 për vitin 2027, 309,000 për vitin 2028 dhe 310,000 për vitin 2029. Rritja e investimeve synon përmirësimin e flotës së mjeteve zjarrfikëse, pajisjeve të reagimit dhe infrastrukturës së mbrojtjes civile.

Programi “Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik” parashikon fonde në vlerën 97,000 për vitin 2027, 104,000 për vitin 2028 dhe 105,000 për vitin 2029. Ky program synon nxitjen e aktivitetit ekonomik lokal, promovimin e sipërmarrjes dhe mbështetjen e sektorëve prioritarë të zhvillimit ekonomik.

Programi “Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Siguria Ushqimore dhe Mbrojtja e Konsumatorëve” parashikon fonde në vlerën 62,000 për vitin 2027, 65,800 për vitin 2028 dhe 66,000 për vitin 2029. Programi mbështet zhvillimin e sektorit bujqësor, garanton standarde sigurie për produktet ushqimore dhe kontribuon në përmirësimin e funksionimit të tregut lokal.

Programi “Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit” parashikon fonde në vlerën 360,000 për vitin 2027, 375,000 për vitin 2028 dhe 380,000 për vitin 2029. Investimet në këtë program synojnë rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe sistemit kullues, duke përmirësuar kushtet e prodhimit bujqësor dhe duke rritur produktivitetin e sektorit rural.

Programi “Administrimi i Pyjeve dhe Kullotave” parashikon fonde në vlerën 82,000 për vitin 2027, 99,000 për vitin 2028 dhe 100,000 për vitin 2029. Ky program synon menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e mjedisit dhe shfrytëzimin racional të pyjeve dhe kullotave.

Programi “Rrjeti Rrugor Rural” përbën zërin më të madh të investimeve në buxhetin afatmesëm. Fondet e parashikuara janë 4,040,507 për vitin 2027, 4,559,553 për vitin 2028 dhe 3,862,601 për vitin 2029. Investimet në këtë program synojnë përmirësimin e infrastrukturës rrugore në zonat rurale, rritjen e aksesit dhe lehtësimin e transportit të produkteve bujqësore.

Programi “Transporti Publik” parashikon fonde në vlerën 107,000 për vitin 2027, 119,000 për vitin 2028 dhe 120,000 për vitin 2029. Investimet në këtë program synojnë përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve të transportit publik.

Programi “Menaxhimi i Mbetjeve” parashikon fonde në vlerën 327,000 për vitin 2027, 334,000 për vitin 2028 dhe 335,000 për vitin 2029. Ky program mbështet përmirësimin e sistemit të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve.

Programi “Strehimi Lokal dhe Urbanistika” paraqet një rritje të konsiderueshme financiare, me fonde në vlerën 790,000 për vitin 2027, 1,220,000 për vitin 2028 dhe 2,240,000 për vitin 2029. Ky program përfshin investime strategjike në zhvillimin urban, rehabilitimin e hapësirave publike dhe projekte infrastrukturore me ndikim afatgjatë.

Programi “Shërbimet Publike Vendore” parashikon fonde në vlerën 515,000 për vitin 2027, 536,000 për vitin 2028 dhe 540,000 për vitin 2029. Programi garanton mirëmbajtjen e ndriçimit publik, hapësirave të gjelbëruara dhe shërbimeve të tjera bazë për komunitetin.

Programi “Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime” parashikon fonde në vlerën 325,000 për vitin 2027, 330,000 për vitin 2028 dhe 350,000 për vitin 2029, me qëllim përmirësimin e rrjeteve të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimeve.

Programi “Sport dhe Argëtim” parashikon fonde në vlerën 325,000 për vitin 2027, 335,000 për vitin 2028 dhe 350,000 për vitin 2029. Investimet në këtë program synojnë ndërtimin dhe rehabilitimin e objekteve sportive dhe hapësirave rekreative.

Programi “Trashëgimia Kulturore, Monumentet, Muzetë dhe Bibliotekat” parashikon fonde në vlerën 110,000 për vitin 2027, 112,000 për vitin 2028 dhe 115,000 për vitin 2029. Programi synon ruajtjen dhe promovimin e vlerave kulturore dhe historike të territorit.

Programet e arsimit, përkatësisht “Arsimi Bazë dhe Parashkollor” dhe “Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm”, parashikojnë fonde për funksionimin dhe mirëmbajtjen e institucioneve arsimore, me vlera respektive 32,000; 34,500; 35,000 dhe 1,500; 1,500; 2,000 për vitet 2027–2029.

Programet sociale, përfshirë “Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët” dhe “Strehimi Social”, mbështesin shtresat në nevojë dhe familjet vulnerabël, me financime përkatësisht 1,700; 1,650; 1,729 dhe 82,000; 89,000; 90,000 për periudhën 2027–2029.

Gjithashtu, për përballimin e situatave të paparashikuara janë planifikuar Fondi i Kontigjencës dhe Fondi Rezervë, të cilët për periudhën 2027–2029 parashikohen respektivisht në vlerat 70,278; 80,332; 83,620 dhe 73,825; 84,385; 87,840.

Në përfundim, tavanet e propozuara për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027–2029 synojnë të garantojnë stabilitet financiar, rritje të investimeve kapitale dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve publike për komunitetin.

Për sa më sipër, propozohet që Këshilli Bashkiak të miratojë tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027–2029, si bazë për vijimin e procesit të hartimit të buxhetit vendor.

DREJTORI

Besa Xhaferi

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
04130 - Mbështetje për zhvillimin ekonomik			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	8,000	8,500	9,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	89,000	95,500	96,000
Tavanet e Përgjithshme	97,000	104,000	105,000
04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëveit			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	5,500	6,000	6,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	56,500	59,800	59,500
Tavanet e Përgjithshme	62,000	65,800	66,000
04240 - Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit			
Shpenzime Personeli (600-601)	2,900	3,200	3,500
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	17,200	17,400	17,800
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	339,900	354,400	358,700
Tavanet e Përgjithshme	360,000	375,000	380,000
04260 - Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave			
Shpenzime Personeli (600-601)	12,000	12,300	12,600
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	28,000	29,000	32,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	42,000	57,700	55,400
Tavanet e Përgjithshme	82,000	99,000	100,000

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
01110 - Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			
Shpenzime Personeli (600-601)	250,000	270,000	275,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	30,000	35,000	40,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	290,000	309,500	300,000
Tavanet e Përgjithshme	570,000	614,500	615,000
05100 - Menaxhimi i mbetjeve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	177,000	180,000	185,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	150,000	154,000	150,000
Tavanet e Përgjithshme	327,000	334,000	335,000
03140 - Shërbimet e Policisë Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	3,000	3,200	3,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	14,000	13,900	13,700
Tavanet e Përgjithshme	17,000	17,100	17,200
03280 - Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile			
Shpenzime Personeli (600-601)	36,500	37,500	38,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	11,000	11,500	12,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	209,500	260,000	260,000
Tavanet e Përgjithshme	257,000	309,000	310,000

Sekretari i GMS: **BESA XHAFERI**Kordinatori i GMS: **PERVIN GJIKURIA**Kryetari i GMS: **VANGJEL TAVO**

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
09120 - Arsimi bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollorlorin)			
Shpenzime Personeli (600-601)	26,500	27,500	28,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	3,500	7,000	7,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	2,000	0	0
Tavanet e Përgjithshme	32,000	34,500	35,000
09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm			
Shpenzime Personeli (600-601)	1,500	1,500	2,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	1,500	1,500	2,000
10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,700	1,650	1,729
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	1,700	1,650	1,729
10661 - Strehimi social			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	7,600	8,000	9,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	74,400	81,000	81,000
Tavanet e Përgjithshme	82,000	89,000	90,000

Sekretari i GMS: **BESA XHAFERI**Koordinatori i GMS: **PERVIN GJIKURIA**Kryetari i GMS: **VANGJEL TAVO**

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
04940 - Fondi Kontigjence			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	70,278	80,332	83,620
Tavanet e Përgjithshme	70,278	80,332	83,620
04910 - Fondi Rezerve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	73,825	84,385	87,840
Tavanet e Përgjithshme	73,825	84,385	87,840

Totali i Shpenzime Personeli (600-601)	406,700	431,100	440,102
Totali i Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	429,900	451,400	472,279
Totali i Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	7,409,210	8,538,820	8,893,609
Tavanet e Përgjithshme	8,245,810	9,421,320	9,805,990

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
06370 - Furnizimi me Uje dhe Kanalizime			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	325,000	330,000	350,000
Tavanet e Përgjithshme	325,000	330,000	350,000
07220 - Sherbimet e Kujdesit Paresor			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	0	0	0
08130 - Sport dhe argëtim			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	6,200	6,550	6,750
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	318,800	328,450	343,250
Tavanet e Përgjithshme	325,000	335,000	350,000
08220 - Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	11,000	13,000	15,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	99,000	99,000	100,000
Tavanet e Përgjithshme	110,000	112,000	115,000

Raporti: PBA1 - Tavanet Përgatitore të PBA

NJVQV: 160 - Bashkia Himarë

PBA: 2027 - 2029

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

	2027	2028	2029
04520 - Rrjeti Rrugor Rural			
Shpenzime Personeli (600-601)	3,300	3,600	4,002
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	28,200	28,600	29,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	4,009,007	4,527,353	3,829,599
Tavanet e Përgjithshme	4,040,507	4,559,553	3,862,601
04570 - Transporti Publik			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	107,000	119,000	120,000
Tavanet e Përgjithshme	107,000	119,000	120,000
06140 - Strehimi lokal dhe urbanistika			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	790,000	1,220,000	2,240,000
Tavanet e Përgjithshme	790,000	1,220,000	2,240,000
06260 - Shërbimet Publike Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	74,000	75,500	77,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	92,000	96,000	98,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	349,000	364,500	365,000
Tavanet e Përgjithshme	515,000	536,000	540,000

Sekretari i GMS: **BESA XHAFERI**

Koordinatori i GMS: **PERVIN GJIKURIA**

Kryetari i GMS: **VANGJEL TAVO**

Projekt Dokumenti i PBA 2027-2029 – Version Pune (Draft) (Faza I).



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E FINANCËS, PLANIFIKIMIT TË BUXHETIT DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 1877/2 Prot

Himarë, më 11.03 2026

Lënda: Relacion shpjegues mbi miratim tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029, Faza 1.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

KËTU

Në zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr 68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 23/2018 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm në njëtitë e pushtetit vendor”i ndryshuar, VKB nr.61 datë 22.12.2025 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe kalendarit të përgatitjes së PBA 2027-2029 dhe buxheti vjetor 2027”, po ju dërgojmë tavanet përgatitore të shpenzimeve të për periudhën 2027–2029 të Bashkisë Himarë.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Tavanet e përgjithshme të shpenzimeve të Bashkisë Himarë për periudhën PBA 2027–2029 planifikohen në rritje progresive vit pas viti, duke reflektuar nevojat në rritje të komunitetit dhe ambiciet e zhvillimit të territorit. Sipas Raportit PBA, totali i tavanet të shpenzimeve është planifikuar si vijon (vlerat në 000 ALL):

Kategoria e Shpenzimit	2027	2028	2029
Shpenzime Personeli	455,000	456,100	457,000
Shpenzime Korrente të Tjera	1,553,800	1,554,000	1,555,000
Shpenzime Kapitale	7,679,623	8,211,220	9,243,990
TOTALI I TAVANETEVE	9,688,423	10,221,320	11,255,990

Parashikimi total i buxhetit pasqyron një rritje prej rreth 5.5% nga viti 2027 në 2028 dhe prej rreth 10.1% nga 2028 në 2029. Kjo dinamikë e rritjes drejtohet kryesisht nga rritja e shpenzimeve kapitale, me fokus të veçantë të infrastruktura rrugore rurale (programi 04520) dhe strehimi lokal e urbanistika (programi 06140).

II. ANALIZA E SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE (PBA)

Tabela e mëposhtme paraqet tavanet përgatitore të shpenzimeve sipas programeve buxhetore për periudhën 2027–2029, të ndara sipas tre kategorive kryesore: Shpenzime Personeli (600-601), Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) dhe Shpenzime Kapitale (230-232, 255). Të gjitha vlerat janë shprehur në mijëra lekë (000 ALL).

Programi / Kategoria e Shpenzimit	2027 (000 ALL)	2028 (000 ALL)	2029 (000 ALL)
01110 – Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi			
Shpenzime Personeli (600-601)	255,000	275,000	280,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	89,000	90,000	95,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	315,000	300,000	320,000
Tavanet e Përgjithshme	659,000	665,000	695,000
05100 – Menaxhimi i Mbetjeve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	177,000	180,000	185,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	150,000	154,000	150,000
Tavanet e Përgjithshme	327,000	334,000	335,000
03140 – Shërbimet e Policisë Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	3,000	3,200	3,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	14,000	13,900	13,700
Tavanet e Përgjithshme	17,000	17,100	17,200
03280 – Mbrojtja nga Zjarri dhe Mbrojtja Civile			
Shpenzime Personeli (600-601)	36,500	37,500	38,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	16,000	15,500	12,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	96,000	96,500	96,500
Tavanet e Përgjithshme	148,500	149,500	146,500
04130 – Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0

Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	8,000	8,500	9,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	89,000	95,500	96,000
Tavanet e Përgjithshme	97,000	104,000	105,000
04220 – Shërbimet Bujqësore, Inspektimi, Ushqimi dhe Mbrojtja e Konsumatorëve			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	5,500	6,000	6,500
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	185,000	187,000	188,000
Tavanet e Përgjithshme	190,500	193,000	194,500
04240 – Menaxhimi i Ujitjes dhe Kullimit			
Shpenzime Personeli (600-601)	2,900	3,200	3,500
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	17,200	17,400	17,800
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	339,900	354,400	358,700
Tavanet e Përgjithshme	360,000	375,000	380,000
04260 – Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave			
Shpenzime Personeli (600-601)	12,000	12,300	12,600
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	28,000	29,000	32,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	42,000	57,700	55,400
Tavanet e Përgjithshme	82,000	99,000	100,000
04520 – Rrjeti Rrugor Rural			
Shpenzime Personeli (600-601)	3,300	3,600	4,002
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	28,200	28,600	29,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	4,239,420	4,245,553	4,194,980
Tavanet e Përgjithshme	4,270,920	4,277,753	4,227,982
04570 – Transporti Publik			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	107,000	119,000	120,000
Tavanet e Përgjithshme	107,000	119,000	120,000

06140 – Strehimi Lokal dhe Urbanistika			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	790,000	1,220,000	2,240,000
Tavanet e Përgjithshme	790,000	1,220,000	2,240,000
06260 – Shërbimet Publike Vendore			
Shpenzime Personeli (600-601)	117,300	95,500	88,898
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	855,000	900,000	900,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	349,000	364,500	365,000
Tavanet e Përgjithshme	1,321,300	1,360,000	1,353,898
06370 – Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	325,000	330,000	350,000
Tavanet e Përgjithshme	325,000	330,000	350,000
07220 – Shërbimi i Kujdesit Paresor			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	0	0	0
08130 – Sport dhe Argëtim			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	6,200	6,550	6,750
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	318,800	328,450	343,250
Tavanet e Përgjithshme	325,000	335,000	350,000
08220 – Trashëgimia Kulturore, Monumentet, Muzete dhe Bibliotekat			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	307,900	252,600	240,721

Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	99,000	99,000	100,000
Tavanet e Përgjithshme	406,900	351,600	340,721
09120 – Arsimi Bazë (përfshirë sistemin e arsimit parashkollor)			
Shpenzime Personeli (600-601)	26,500	27,500	28,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	3,500	7,000	7,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	2,000	0	0
Tavanet e Përgjithshme	32,000	34,500	35,000
09230 – Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm			
Shpenzime Personeli (600-601)	1,500	1,500	2,000
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	0	0	0
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	1,500	1,500	2,000
10430 – Kujdesi Social për Familjet dhe Fëmijët			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	1,700	1,650	1,729
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	0	0	0
Tavanet e Përgjithshme	1,700	1,650	1,729
10661 – Strehimi Social			
Shpenzime Personeli (600-601)	0	0	0
Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	7,600	8,000	9,000
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	74,400	81,000	81,000
Tavanet e Përgjithshme	82,000	89,000	90,000
04940 – Fondi i Kontigjencës			
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	70,278	80,332	83,620
Tavanet e Përgjithshme	70,278	80,332	83,620
04910 – Fondi Rezervë			
Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	73,825	84,385	87,840
Tavanet e Përgjithshme	73,825	84,385	87,840

TOTALI – Shpenzime Personeli (600-601)	455,000	456,100	457,000
TOTALI – Shpenzime Korrente të Tjera	1,553,800	1,554,000	1,555,000
TOTALI – Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	7,679,623	8,211,220	9,243,990
TAVANET E PËRGJITHSHME – TOTALI	9,688,423	10,221,320	11,255,990

2.1 Analiza mbi Programet Kryesore

Programi 04520 – Rrjeti Rrugor Rural

Ky program përbën volumin më të madh të investimeve kapitale të bashkisë. Tavanet e Shpenzimeve Kapitale planifikohen në 4,239,420 mijë lekë për vitin 2027, 4,245,553 mijë lekë në 2028 dhe 4,194,980 mijë lekë në 2029. Ky investim i konsiderueshëm reflekton prioritetin strategjik të bashkisë për lidhjen e zonave rurale dhe përmirësimin e aksesit të komuniteteve të izoluara.

Programi 06140 – Strehimi Lokal dhe Urbanistika

Ky program shfaq rritjen më dinamike të periudhës PBA, duke kaluar nga 790,000 mijë lekë në vitin 2027, në 1,220,000 mijë lekë në vitin 2028, dhe duke arritur në 2,240,000 mijë lekë në vitin 2029 – pothuajse trefish rritje brenda tre vjetëve. Kjo rritje tregon investim të konsiderueshëm në rregullimin e territorit, urbanistikën dhe zgjidhjen e problematikës së strehimit.

Programi 06260 – Shërbimet Publike Vendore

Ky program ka tavanet totale prej 1,321,300 mijë lekë (2027), 1,360,000 mijë lekë (2028) dhe 1,353,898 mijë lekë (2029), duke shënuar stabilitet relative. Shpenzimet Korrente të Tjera dominojnë me 855,000–900,000 mijë lekë në vit, çka tregon kosto operative të larta për shërbime si pastrimi, gjelbërimi dhe ndriçimi publik.

Programi 08220 – Trashëgimia Kulturore

Vërehet një ulje progresive e shpenzimeve korrente (nga 307,900 mijë lekë në 2027, në 252,600 mijë lekë në 2028 dhe 240,721 mijë lekë në 2029), ndërkohë që shpenzimet kapitale ruhen stabël rreth 99,000–100,000 mijë lekë. Totali i programit bien nga 406,900 mijë lekë (2027) në 340,721 mijë lekë (2029).

Programi 01110 – Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi

